



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo



PROKURORIA THEMELORE PRIZREN/  
OSNOVNO TUŽILAŠTVO U PRIZREN/ BASIC PROSECUTION IN PRIZREN



# BULETINI I PROKURORISË THEMELORE NË PRIZREN

Janar - Mars 2025

*Përmes këtij buletini do të pasqyrohen aktivitetet kryesore, të cilat janë realizuar në Prokurorinë Themelore në Prizren, për periudhën kohore Janar-Mars 2025*

## **Kryeprokurori i Prokurorisë së Prizrenit Mban Takim me Shoqërinë Civile dhe Mediat**

**Prizren, 09 Janar 2025**

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, Petrit Kryeziu, ka mbajtur tryezë diskutimi me përfaqësues të shoqërisë civile dhe mediave, ku para tyre ka prezantuar *“draft/planin e punës për Prokurorinë Themelore të Prizrenit për vitin 2025”*.

Kryeprokurori Kryeziu, para të pranishmëve theksoi se kjo tryezë ka për qëllim të paraqesë në mënyrë të strukturuar objektivat dhe planin e veprimit për periudhën Janar - Dhjetor 2025.

Në takim, Kryeprokurori Kryeziu, potencoi se plani i punës për vitin 2025 mes tjerash ka për qëllim ngritjen e efikasitetit, transparencës dhe llogaridhënies si dhe rritjen e besimit të publikut.

Ai, theksoi se plani i punës në vete përmban organizimin e prokurorisë dhe përmban njëzet objektiva, ku bëri një prezantim të shkurtër për secilën objektivë veç e veç, ku ndër të tjera theksoi se pesë objektivat kryesore për vitin 2025 do të jenë: luftimi i veprave penale kundër korrupsionit, fajdeja, narkotikët, dhuna në familje dhe krimet kundër mjedisit.

Gjithashtu, në këtë takim ishin të pranishëm edhe prokurorë përfaqësues nga tri departamentet e kësaj prokurorie.

Përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe mediave, patën mundësinë që të japin vërejtje dhe rekomandime për planin e punës së prokurorisë.

Të pranishmit vlerësuan se diskutimet e tilla janë të mirëseardhura dhe janë në interes të përgjithshëm për luftimin e veprave penale që janë nën kompetencën ligjore dhe territoriale të Prokurorisë Themelore të Prizrenit. Të pranishmit parashtruan pyetje lidhur me çështje të ndryshme që kjo prokurori i ka në trajtim, për të cilat morrën përgjigje nga Kryeprokurori Kryeziu

Kryeprokurori Kryeziu, falenderoi të pranishmit për kontributin e tyre, ku njëkohësisht u zotua se rekomandimet e marra gjatë këtij takimi do të shqyrtohen për përfshirjen e tyre si pjesë e planit final të punës, i cili do hartohet nga kjo prokurori.



## Aktakuzë për Korrupsion

**Prizren, 10 Janar 2025**

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurve I.B., dhe Sh.P., për shkak të dyshimit të bazuar mirë që secili veç e veç kanë kryer veprën penale “Ushtrimi i ndikimit” nga neni 424 par. 1 dhe par.2, sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Sipas aktakuzës, i pandehuri I.B., nga data 03.10.2022 deri me datë 05.01.2023, në Prizren, në mënyrë të drejtëpërdrejtë pranon premtimin për një përfitim për vete me pretendimin se ai është në gjendje të ushtroj ndikim të padrejtë mbi vendimmarrjen e personit zyrtar, në atë mënyrë që pranon se do të ushtrojë ndikim të padrejtë tek bashkëshortja e tij, M.P., e cila ka qenë anëtare e Komisionit në konkursin e shpallur nga Komuna e Prizrenit – Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, të datës 03.10.2022, për vendin e punës sekretare në njërin prej gjimnazeve dhe në njërin prej shkollave fillore në Komunën e Prizrenit, në bazë të të cilit konkurs kishte aplikuar E.P.S., ku i dërgon pyetje nga testi me shkrim, gjithashtu i jep informacion për poentimin maksimal prej 100 pikësh, të dhënë nga bashkëshortja e tij M.P, si anëtare e komisionit, të gjitha këto dhe të tjera komunikime, rezultuan nga komunikimet që i ka zhvilluar i pandehuri, I.B., me të pandehurin Sh.P., në aplikacionet e rrjeteve sociale “Viber” dhe “Whats App”.

I pandehuri Sh.P., në mënyrë të drejtëpërdrejtë i premtim përfitim personit tjetër – të pandehurit I.B., në atë mënyrë që ky i fundit të ushtroj ndikim të papërshtatshëm mbi vendimmarrjen e personit zyrtar, në atë mënyrë që i pandehuri Sh.P., të pandehurit I.B., i premtim se do t’ia kryej një punë këtij të fundit, për ndikimin që do ta bëjë i pandehuri I.B., tek bashkëshortja e tij, M.P, si anëtare e komisionit.

Ndërsa i pandehuri, I.B, ia dërgon në telefon të pandehurit Sh.P, kopjen e ftesës me të cilën është ftuar ai si i pandehur lidhur me një çështje penale që zhvillohej pranë Gjykatës Themelore në Prizren.

Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre, të pandehurit e lartëcekur për veprat penale për të cilat akuzohen të shpallen fajtorë dhe të dënohen sipas ligjit.



## Aktakuzë Kundër Katër Personave për Shitblerje të Narkotikëve

**Prizren, 20 Janar 2025**

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurve M.M., N.U., S.S., dhe N.K., për shkak të dyshimit të bazuar mirë se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 267, par. 2 lidhur me nenin 275 par. 1 pika 1.9 e lidhur me nenin 31 sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).


Sipas aktakuzës, të pandehurit M.M., N.U., S.S., dhe N.K., deri më datë 20.04.2024, pa autorizim posedojnë me qëllim të shitjes apo shpërndarjes, ose ofrojnë për shitje substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, në atë mënyrë që pasi substancën narkotike e kishin siguruar nga Republika e Shqipërisë, të njëjtën e kishin fshehur në fshatin Greikoc - Komuna e Suharekës, në shtëpinë e të pandehurit S.S., e cila gjendet në rrugën “8 Martirët”, dhe të njëjtën substancë narkotike ia ofrojnë për shitje dy personave në njërën prej pompave të derivateve, në rrugën e transitit në Prizren, ashtu që derisa të pandehurit N.K., M.M., dhe N.U., me një person qëndrojnë në pompën e derivateve, i pandehuri S.S., me personin tjetër - blerësin potencial shkojnë në fshatin Greikoc në shtëpinë e të pandehurit S.S., për ta verifikuar substancën narkotike, me ç’ rast sipas urdhëresës së Gjykatës Themelore në Prizren, kontrollohet shtëpia e S.S., ku policia gjen *49 kg e 750 gram substancë narkotike të llojit “marihuanë” të sistemuara në pesë (5) paketime.*

Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre, të pandehurit e lartëcekur për veprat penale për të cilat akuzohen të shpallen fajtorë dhe të dënohen sipas ligjit.

PROKURORIA THEMELORE NË PRIZREN

Aktakuzë Kundër Katër Personave  
për Shitblerje të Narkotikëve

20 Janar 2025





## Arrestohet Një Person për Kanosje të Viktimës së Fajdesë

**Prizren, 21 Janar 2025**

Prokuroria Themelore në Prizren, njofton opinionin publik se, pas ndërmarrjes së veprimeve hetimore, në bashkëpunim me Sektorin Rajonal të Hetimeve - DRP në Prizren, ka arritur që me datë 20.01.2025 të arrestoj një person të dyshuar, në pikën kufitare në Merdare. I njëjti dyshohet se ka kryer veprën penale “Kanosja” nga neni 181, sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

I pandehuri i arrestuar, dyshohet se me datë 06.12.2024 ka kanosur viktimën e fajdesë, përmes rrjetit social “Facebook”, duke i shkruar mesazhe me përmbajtje kërcënuese, duke kërkuar nga i njëjti që të tërhiqet nga deklarata në rastin e fajdesë që kjo prokurori e ka nën hetim. I njëjti ka lidhje të afërta familjare me të dyshuarin, i cili gjendet në paraburgim për veprën penale “Fajdeja” nga neni 331 sipas KPRK-së.

I pandehuri i arrestuar, gjendet nën masën e ndalimit 48 orësh, dhe brenda afatit ligjor, për të njëjtin, prokuroria do të parashtroj kërkesë për caktim të masës së paraburgimit.

Prokuroria Themelore në Prizren, vazhdon të mbetet e përkushtuar në luftën ndaj kriminalitetit, forcimin e sundimit të ligjit dhe vënien para drejtësisë të të gjithë atyre që bien ndesh me ligjin.



## PROKURORIA THEMELORE NË PRIZREN



- **Arrestohet Një Person për Kanosje të Viktimës së Fajdesë**

## Prokuroria e Prizrenit Kërkon Paraburgim për të Arrestuarin për Vjedhje të Rëndë në Argjendari

**Prizren, 26 Janar 2025**

Prokuroria Themelore në Prizren, njofton opinionin publik se, pas ndërmarrjes së veprimeve hetimore dhe pas një pune operative, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës - Drejtorinë Rajonale në Prizren, kanë arritur që me datë 24.01.2025 të arrestojnë personin me inicialet Sh.H., nga fshati Greme - Komuna e Ferizajt, për shkak të dyshimit të bazuar se në bashkëkryerje ka kryer veprën penale “Vjedhja e rëndë” nga neni 315 par. 2, nën.par.2.1 lidhur me par.1 dhe lidhur me nenin 31, sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

I pandehuri i arrestuar, dyshohet se me datë 12.01.2025, rreth orës 03:45min, në njërën prej argjendarive në Prizren, duke vepruar në bashkëveprim me të pandehurit tjerë NN (gjer më tani të paidentifikuar), pas një planifikimi paraprak dhe koordinimi në mes vete, me qëllim që vetes t’i sjellin dobi pasurore të kundërligjshme, ia marrin pasurinë të dëmtuarit A.B., (pronar i argjendarisë), në atë mënyrë që duke shfrytëzuar momentin kur në lokalin e të dëmtuarit nuk ishte askush, me përdorim të forcës fizike dhe të pajisur me mjete të përshtatshme e hapin derën e lokalit dhe e dëmtojnë alarmin, ku hyjnë brenda në lokal. Më pas depërtojnë në lokal, e dëmtojnë kasafortën dhe arrijnë ta hapin dhe të marrin 3 kg ari ( tre kilogram) dhe 1 kg argjend (një kilogram) në vlerë prej 168.000.00 € (njëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë euro) dhe pastaj të pandehurit largohen nga dera kryesore në drejtim të panjohur.

Po ashtu, lidhur me rastin me kërkesë të Prokurorisë Themelore në Prizren, është lëshuar urdhërkontrolli nga Gjykata Themelore në Prizren, ku janë kontrolluar objekti i banimit i të dyshuarit së bashku me objektet përcjellëse në fshatin Greme.

Gjatë kontrollit janë gjetur dëshmi dhe prova të shumta të cilat janë sekuestruar. Gjithashtu, si provë materiale është sekuestruar automjeti me të cilin është kryer vepra

penale. Prokuroria Themelore në Prizren, për të pandehurin Sh.H., brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë për caktim të masës së paraburgimit.

Prokuroria Themelore në Prizren, vazhdon të mbetet e përkushtuar në luftën ndaj kriminalitetit, forcimin e sundimit të ligjit dhe vënien para drejtësisë të të gjithë atyre që bien ndesh me ligjin.



## Aktakuzë Kundër Katër Personave për Shitblerje të Narkotikëve

**Prizren, 03 Shkurt 2025**

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurve D.T., E.D., R.V., dhe P.S., të cilët gjenden nën masën e paraburgimit nga data 06.06.2024, për shkak të dyshimit të bazuar mirë se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 267 par. 2 lidhur me nenin 275 parag. 1 nënparag. 1.9 dhe nenin 31, sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Sipas aktakuzës, më datë 05.06.2024, rreth orës 22:38<sup>min</sup>, të akuzuarit D.T., E.D., R.V., dhe P.S., pa autorizim transportojnë me qëllim të shitjes dhe shpërndarjes, sasi të konsiderueshme të narkotikëve, të cilët janë shpallur të ndaluara me ligj, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm, në atë mënyrë që të akuzuarit vendosin narkotikët në bagazhet e dy automjeteve VV Golf 7, dhe nisen në drejtim të kufirit Kosovë – Shqipëri për të shkuar në Shëngjin në festivalin “Unum”. Gjatë rrugës, pasi tejkalojnë shpejtësinë e lëvizjes, automjetit të parë që drejtohej nga E.D., i shqiptohet tiketa nga ana e policisë, dhe në ato momente i pandehuri D.T., që ishte në veturën e dytë, pasi kishte ndaluar veturën shkon tek vetura e parë, ku e tërheq një çantë krahu nga automjeti dhe e gjuan në një largësi rreth pesë metra, me ç’rast pas shqiptimit të tiketave, i njëjti shkon në të njëjtin vend për të marrë çantën me qëllim që ta vendos në veturë, me ç’rast zyrtarët policorë reagojnë dhe gjatë kontrollimit të çantës vërejnë substanca të konsiderueshme narkotike të vendosura në qese të najlonit, ku sipas ekzaminimit të laboratorit, të datës 21.01.2025 kanë rezultuar si në vijim:

- Kokainë të përzier me fenacetin me peshë neto të përgjithshme për dhjetë paketime 7.78 gram – Kokainë pesha neto 132.16 gram,
- Kokainë të përzier me fenacetin me peshë 66.30 gram,

- MDMA Methylenedioksiymethapfenatime (MDMA) pesha neto 693.28 gram,
- MDMA pesha neto e përgjithshme 841.21 gram,
- MDMA 305 qese me peshë prej 305.66 gram
- MDMA dhe ketamin të përzier me kafeinë gjithsej 296 qese, me peshë 319.14 gram,
- MDMA dhe ketamin të përzier me kafeinë pesha neto 0.98 gram,
- MDMA pesha neto e përgjithshme 470.22 gram,
- Substancë narkotike kokainë të përzier me fenacetin pesha neto për tetë paketime 6.40 gram,
- MDMA 1.13 gram, ketamin pesha neto 273.17 gram, ketamin pesha neto për 18 qese 165.69 gram,
- MDMA dhe ketamin në përzierje me kafeinë pesha neto 5.49 gram,
- MDMA dhe ketamin në përzierje me kafeinë pesha neto 0.93 gram
- MDMA dhe ketamin në përzierje me kafeinë pesha neto 1.54 gram,
- MDMA pesha neto 2.24 gram
- Substancë psikotrope e llojit kanabis me peshë 4.60 gram,
- MDMA me pesha neto 11.39 gram,
- MDMA me peshë neto 1212.9 gram
- MDMA me peshë neto 912.70 gram,
- Substancë narkotike e llojit kanabis me peshë 0.31 gram.

Prokurori i çështjes, ka propozuar vazhdimin e masës së paraburgimit ndaj të akuzuarve, si dhe në kuptim të nenit 269 par. 2 dhe 270 dhe 276 par. 2 nëpar. 2.2 dhe 2.5 të KPP-së, ka propozuar që si dënim plotësues të bëhet konfiskimi i përhershëm i sendeve të sekuestruara, po ashtu të konfiskohen dy vetura VV Golf 7, si dhe nga të katër të pandehurit të konfiskohet shuma rreth 7.788 euro, dhe 100 dollar, para të përfituara nga vepra penale.

Gjithashtu, prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre, të

pandehurit e lartëcekur për veprën penale për të cilën akuzohen të shpallen fajtorë dhe të dënohen sipas ligjit.

**PROKURORIA THEMELORE NË PRIZREN**

**Aktakuzë Kundër Katër Personave për  
Shitblerje të Narkotikëve**

03 Shkurt 2025



## Aktakuzë për Kontrabandim me Migrantë

**Prizren, 11 Shkurt 2025**

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurit Q.K., për shkak të dyshimit të bazuar mirë se ka kryer veprën penale “Kontrabandimi me migrantë” nga neni 164, par.1, sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Sipas aktakuzës, me datë 10.12.2024, në ora 22:25<sup>min</sup>, në fshatin Vërmicë – Komuna e Prizrenit – saktësisht në dalje nga autostrada “Ibrahim Rugova” për në fshatin Vërmicë, merret me kontrabandim të migrantëve, në atë mënyrë që, derisa ishte duke e drejtuar automjetin e tij, ndalohet nga ana e Policisë Kufitare, i cili kishte qenë duke i bartur katër (4) emigrantë (shtetas të Bangladeshit), për të cilët ishte pajtuar që për një shumë parash në vlerë prej 150 € (njëqind e pesëdhjetë euro) t’i dërgojë deri në Gjilan, edhe pse kishte qenë fare mirë në dijeni se të njëjtit ishin futur ilegalisht në territorin e Kosovës.

Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre, i pandehuri i lartëcekur për veprën penale për të cilën akuzohet të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.





## Aktakuzë për Shitblerje të Narkotikëve

**Prizren, 13 Shkurt 2025**

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurit K.T., për shkak të dyshimit të bazuar mirë se ka kryer veprën penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 267 par. 2 lidhur me nenin 275 par. 1 nënparag. 1.9 sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Sipas aktakuzës, i akuzuari K.T., përgjatë periudhës kohore Tetor – Nëntor 2024, në kohë të pacaktuar në Prizren, pa autorizim shpërndanë dhe shet substancë psikotrope të llojit mariuhanë në sasi të mëdha, të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, në atë mënyrë që pas një kontrolli nga ana e policisë në banesën e tij më datë 11.11.2024, rreth orës 11:40 min, në Prizren, i janë gjetur:

- Tetëmbëdhjetë (18) qese najloni të përgatitura për shitje me substancë narkotike të llojit mariuhanë me peshë 32.62 gram,
- Një (1) foli alumini me substancë narkotike e llojit mariuhanë me peshë prej 3.02 gram,
- Substancë narkotike e llojit mariuhanë me peshë prej 1.58 gram,
- Një (1) kavanoz qelqi brenda së cilës gjendej substanca narkotike e llojit mariuhanë me peshë 1.32 gram,
- Një (1) qese najloni me substancë e llojit mariuhanë me peshë 45.52 gram,
- Një (1) kavanoz qelqi brenda me substancën narkotike e llojit mariuhanë me peshë 49.74 gram,
- Substancë e llojit mariuhanë në peshë prej 1.41 gram,
- Pesëmbëdhjetë (15) qese të vogla paketimi dhe dymbëdhjetë (12) të mëdha,
- Një (1) rrole me foli alumini,
- Një (1) peshore digjitale me mbishkrim CONSTANT,
- Qese najloni për paketime, si dhe 6x10 €.

Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre, i

pandehuri i lartëcekur për veprën penale për të cilën akuzohet të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

**PROKURORIA THEMELORE  
NË PRIZREN**

Aktakuzë për Shitblerje të  
Narkotikëve

Prizren, 13 Shkurt 2025



## Njoftim lidhur me Aksionin e Prokurorisë së Prizrenit kundër Fajdesë

### Prizren, 25 Shkurt 2025

Prokuroria Themelore në Prizren, njofton opinionin publik se, pas një hetimi disa mujor në bashkëpunim me Njësinë Rajonale të Policisë në Prizren, Drejtorinë për Krim të Organizuar dhe Njësinë NJSO, është realizuar kontroll në dy lokacione me ç'rast janë arrestuar dy të dyshuar D.G., dhe L.G., për shkak të dyshimit të bazuar se të njëjtit kanë kryer veprën penale "Fajdeja" nga neni 331 par. 2, lidhur me par.1 lidhur me nenin 31, sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Të pandehurit e arrestuar, dyshohet se duke shfrytëzuar gjendjen e rënduar financiare të viktimës, të njëjtit i kanë dhënë të holla me kamata mujore prej 15% - 20%. I dëmtuari disa herë ka paguar kamata, dhe kur i njëjti nuk ka arritur që t'i paguaj kamatat mujore, të pandehurit i kanë vënë kamata javore, me ç' rast si rezultat i kamatave të larta, kanë arritur vlera të pa përballueshme për viktimën.

Kontrolli është realizuar në regjionin e Prizrenit, ku pas grumbullimit të provave gjatë aplikimit të masave të veçanta hetimore në terren, të pandehurit janë arrestuar.

Gjatë këtij aksioni, Prokurori i Shtetit, ka sekuestruar dy (2) automjete, armë, të holla të gatshme dhe prova tjera materiale, në drejtim të veprës së lartëcekur.

Të pandehurit e arrestuar, gjenden nën masën e ndalimit 48 orësh, dhe brenda afatit ligjor, për të njëjtit, prokuroria do të parashtroj kërkesë për caktim të masës së paraburgimit.

Prokuroria Themelore në Prizren, vazhdon të mbetet e përkushtuar në luftën ndaj kriminalitetit, forcimin e sundimit të ligjit dhe vënien para drejtësisë të të gjithë atyre që bien ndesh me ligjin.



## Prokuroria e Prizrenit Kërkon Paraburgim për Dhjetë Persona

**Prizren, 02 Mars 2025**

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, njofton opinionin publik se ka kërkuar nga Gjykata Themelore në Prizren, caktimin e masës së paraburgimit në afat prej 30 ditësh, ndaj dhjetë (10) personave të dyshuar: L.R., për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale "Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm" nga neni 294 par. 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, dhe P.B., B.Q., F.C., B.K., P.Sh., N.R., S.B., R.A., dhe M.Sh., për shkak të dyshimit të bazuar se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale "Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm" nga neni 294 par.2 lidhur me nenin 31, sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Sipas kërkesës, me datë 28.02.2025, rreth orës 23:00 minuta, në Suharekë, në kafiterinë "R.G.Z", i pandehuri L.R., (pronar i lokalit), me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, organizon dhe merr pjesë në organizimin e lojërave të fatit, të cilat janë të ndaluara me Ligjin Nr.06/L-155 për ndalimin e lojërave të fatit, ashtu që në mënyrë të kundërligjshme dhe të fshehtë, lokalit e përdorë për lojëra të fatit, ku me rastin e lokalizimit të vendit nga zyrtarët policor kur të njëjtit tentojnë të hyjnë në lokal, dera e lokalit ishte e mbyllur me çelës nga brenda, dhe ishte me pak ndriçim, e pas tentimit të zyrtarëve për ta hapur derën, aty i pandehuri L.R., e hap derën, ku gjatë kontrollit nga zyrtarët policorë brenda në lokal në tavolinat ku kanë qenë ulur të pandehurit e lartëcekur janë hasur në total dyqind e tetë (208) letra, nëntëdhjetë e gjashtë (96) kartela me mbishkrimin AliExpress me barcode, të cilat dyshohet se janë kartela për lojërat e fatit online.

Po ashtu, nga të pandehurit e lartëcekur janë sekuestruar në total pesëmbëdhjetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë euro (15.260 €), dhe njëmijë e dyqind franga Zvicerane (1.200 CHF). Gjithashtu, tek i pandehuri L.R., - pronari i lokalit të lartcekur janë gjetur letra në sasi prej tremijë e treqind e njëzet e gjashtë (3326 copë), të cilat janë përdorur për lojë bixhozi natën kritike.

Të pandehurit L.R.,P.B., B.Q., F.C., B.K., P.Sh., N.R., S.B., R.A., dhe M.Sh., gjenden në ndalim 48 orësh nga data 01.03.2025 për veprën penale të lartëcekur.

Prokuroria Themelore në Prizren, vazhdon të mbetet e përkushtuar në luftën kundër kriminalitetit, forcimin e sundimit të ligjit dhe vënien para drejtësisë të të gjithë atyre që bien ndesh me ligjin.



## Aktakuzë për Keqpërdorim të Pozitës Zyrtare dhe Falsifikim të Dokumenteve Zyrtare

**Prizren, 04 Mars 2025**

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurit I.B., për shkak të dyshimit të bazuar se i njëjti ka kryer veprat penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 414 par. 1 lidhur me par. 3 nëpar. 3.4, si dhe “Falsifikimi i dokumenteve zyrtare” nga neni 427 parag. 1, lidhur me par. 2, sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Sipas aktakuzës, në periudhën kohore prej marsit të vitit 2021 deri në qershor të vitit 2022 në Prizren, në kohë të pacaktuar në cilësinë e personit zyrtar – si U.D. drejtor i njëjës prej shkollave të mesme në Prizren, duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo t’i shkaktoj dëm personit tjetër, në atë mënyrë që kontraktton investitor – firmën “E.B.” për servisimin dhe riparimin e kalldasë dhe radiatorëve të shkollës në shumën prej 995 €, firmën N.P.“E.” për gjelbërimin e shkollës me lule dhe fidanë në shumë prej 899.50 €, firmën N.T.Sh. “Q.” për pastrimin dhe mirëmbajtjen e ollukëve të kulmit të shkollës në shumën prej 995.40 €, dhe operatorin DPT “I.” për furnizimin e shkollës me material për zyre në shumë prej 980 €, ashtu që ka realizuar pagesat në bazë të procesverbaleve, pa i pranuar shërbimet e operatorëve nga anëtarët e komisionit që figurojnë në procesverbalet të cilat kanë deklaruar se nënshkrimet nuk janë të atyre, dhe nuk i kanë pranuar këto mallra dhe shërbime, që kapin shumën 3.869,90 €, duke i shkaktuar dëm buxhetit komunal në Prizren.


Me këto veprime, i njëjti ka kryer veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” sipas KPRK-së.

Gjithashtu, i njëjti prej 26.07.2021 deri më 15.11.2021, në cilësinë e personit zyrtar – si U.D. drejtor i njëjës prej shkollave të mesme në Prizren, ka falsifikuar dokumentet zyrtare, në atë mënyrë që ka përpiluar dhe lëshuar dokumentin në emër të anëtarëve të komisionit

të shkollës të cilëve iu ka munguar vendimi se janë anëtarë të komisionit, duke i nënshkruar procesverbalet pa njohurinë e anëtarëve të komisionit dhe atë në emër të: A.B., E.S., E.N., R.M., Sh.M., A.D., A.I. dhe D.B., ku në bazë të këtyre procesverbaleve janë realizuar pagesa për operatorët e lartëcekur pa dijeninë, nënshkrimin dhe prezencën e anëtarëve të komisionit, të cilët kanë mohuar pranimin mallrave dhe shërbimeve për nevojat e shkollës.

Me këto veprime, i njëjti ka kryer veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve zyrtare” sipas KPRK-së.

Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre, i pandehuri i lartëcekur për veprat penale për të cilat akuzohet të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.





## Pensionohet Prokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren

Prizren, 07 Mars 2025

Prokuroria Themelore në Prizren, ka organizuar takim përshëndetës për prokurorin Besim Susuri, i cili ka arritur moshën e pensionimit dhe me këtë rast ka përfunduar edhe mandatin si prokuror.

Në këtë takim, Kryeprokurori Petrit Kryeziu, prokurorët dhe stafi i Prokurorisë Themelore në Prizren, falenderuan prokurorin Besim Susuri për punën dhe kontributin e dhënë në sistemin prokurorial, duke çmuar lart përkushtimin dhe profesionalizmin e treguar përgjatë këtyre viteve.

Nga ana tjetër, prokurori i pensionuar, Besim Susuri ka falenderuar të gjithë punonjësit e Prokurorisë Themelore në Prizren për respektin, mbështetjen dhe bashkëpunimin që ka pasur me ta gjatë periudhës së punës në këtë prokurori.



**Prokuroria e Prizrenit Kërkon Paraburgim për të Pandehurit që u Kapën me mbi 12  
Kilogram Narkotik**

**Prizren, 08 Mars 2025**

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, njofton opinionin publik se ka kërkuar nga Gjykata Themelore në Prizren, caktimin e masës së paraburgimit në afat prej 30 ditësh, ndaj dy (2) personave të dyshuar: N.I., dhe E.M., për shkak të dyshimit të bazuar se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale “Blerja posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 267, par.2 lidhur me nenin 275 par.1 pika 1.9 lidhur me nenin 31, gjithashtu i pandehuri N.I., ka kryer veprat penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 267, par.2 dhe “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366, par.1, sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Sipas kërkesës, i pandehuri i parë N.I., me datë 28.02.2025, pa autorizim shet, transporton, dorëzon dhe dërgon në transit substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, me qëllim shitjes në atë mënyrë që pas marrëveshjes paraprake me personin me emrin “T.” për shitblerje të substancës narkotike, takohet me të njëjtin në afërsi të fshatit Landovicë - Komuna e Prizrenit, të cilit në bazë të marrëveshjes ia shet substancën narkotike të llojit Marihuanë me peshë prej **1019.66** gram, të vendosura në një qese plastike me ngjyrë të zezë, në këmbim të vlerës prej **2,400.00** (Dymijë e katërqind euro). Me këto veprime, i njëjti ka kryer veprën penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” sipas KPRK-së.

Po ashtu, të pandehurit N.I., dhe E.M., me datë 07.03.2025 rreth orës 21:30 minuta, në afërsi të fshatit Landovicë - Komuna e Prizrenit, në bashkëkryerje, pa autorizim shesin, transportojnë, dorëzojnë dhe dërgojnë në transit substanca apo preparate, të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, në atë mënyrë që pas marrëveshjes paraprake përmes

telefonit me personin e quajtur "T.", i pandehuri i parë N.I., vjen me veturën e tij të markës "Audi" dhe pasi takohet me personat "T." dhe "E." në parkingun e pompës së derivateve "K.P.", hip në veturën e tyre dhe paraprakisht kërkon që t'i shohë paratë, të cilat edhe i numëron dhe menjëherë e merr në telefon të pandehurin e tretë H.H., (i cili gjendet në arrati), me ç' rast ky i fundit duke qenë i shoqëruar edhe nga i pandehuri i dytë E.M., pas pak minutash afrohen me veturën e markës "VW Bora", dhe me të arritur në afërsi të parkingut të ish-hotel "V.", që të dy dalin nga vetura dhe së bashku nxjerrin një qese me ngjyrë të kaltër brenda së cilës ishin 11 (njëmbëdhjetë) foli alumini me substancë të dyshuar narkotike të llojit marihuanë, me peshë të përgjithshme prej **10,510.36** (Dhjetë kilogram e pesëqind e dhjetë gram e tridhjetë e gjashtë miligram) në vlerë prej **25,000.00 Euro** (Njëzet e pesëmijë euro) dhe në atë moment, menjëherë kanë reaguuar forcat e policisë, të cilët kanë arritur ta arrestojnë të pandehurin e parë dhe të pandehurin e dytë, ndërsa i pandehuri i tretë H.H., ka arritur të largohet nga vendi i ngjarjes dhe vazhdon të jetë në arrati, derisa pas bastisjes së shtëpisë dhe objekteve përcjellëse të të pandehurit N.I., policia ka arritur të gjejë dhe sekuestrojë edhe një sasi të substancës së dyshuar narkotike të llojit marihuanë në peshë prej **1,218.00 gram** (një kilogram e dyqind e tetëmbëdhjetë gram), dy peshore të cilat shërbejnë për matjen – peshimin e substancave narkotike, të cilat destinohen për shitje dhe një shumë parash prej **3,965.00 Euro** (Tremijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë euro), të cilat para dyshohen të jenë përfituar nga kryerja e veprës penale.

Në këtë mënyrë, të pandehurit e lartëcekur në bashkëkryerje ka kanë kryer veprën penale "Blerja posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge" sipas KPRK-së.

Po ashtu, i pandehuri i parë N.I., pa lejen e organit kompetent mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, në atë mënyrë që pas arrestimit nga ana e policisë, të njëjtit i është gjetur një pistoletë e kalibrit 7.62 mm, së bashku me një karikator me 8 fishekë, derisa pas zbatimit të urdhër

kontrollit tek shtëpia e tij, gjejnë edhe katër (4) fishekë të pistoletës dhe pajisjes për pastrimin e armës. Me këto veprime, i njëjti ka kryer veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” sipas KPRK-së.

Të pandehurit N.I., dhe E.M., gjenden në ndalim 48 orësh nga data 07.03.2025 për veprat penale të lartëcekura. Prokuroria Themelore në Prizren, vazhdon të mbetet e përkushtuar në luftën kundër kriminalitetit, forcimin e sundimit të ligjit dhe vënien para drejtësisë të të gjithë atyre që bien ndesh me ligjin.




## Njoftim lidhur me Aksionin e Prokurorisë së Prizrenit kundër Fajdesë

**Prizren, 13 Mars 2025**

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Krimeve të Rënda, njofton opinionion publik se, pas një hetimi disa mujor në bashkëpunim me Njësinë Rajonale të Policisë në Prizren - Drejtorinë për Krim të Organizuar, kanë realizuar kontroll në regjionin e Prizrenit, me ç’rast është arrestuar i dyshuari E.K., për shkak të dyshimit të bazuar se i njëjti ka kryer veprën penale “Fajdeja” nga neni 331 par.3, lidhur me par.1 dhe nenin 77 lidhur me nenin 31, sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

I pandehuri E.K., që nga koha e pavërtetuar dhe në vazhdimësi - deri në muajin Mars të këtij viti, në Prizren, në bashkëveprim edhe me persona të tjerë, për vete pranojnë dhe kontraktjnë shuma dukshëm jo-proporcionale të pasurisë në këmbim të shërbimit për personin tjetër, duke shfrytëzuar gjendjen e rëndë financiare të personit të tillë, varfërinë dhe papërvojën e tij, në atë mënyrë që i japin viktimës para (të holla) në formë të borxhit me kamata të paligjshme (fajde), të cilat kamata vazhdojnë t’ia rrisin pandërprerë sa herë që viktimë has në vonesa të kthimit të parave, me ç’rast secili nga të pandehurit në koordinim me njëri – tjetrin, e kontaktojnë rregullisht viktimën në telefon herë duke ia kërkuar paratë e herë duke i ofruar mundësi për të marrë sërish para me kamata të paligjshme duke i shkaktuar deri më tani dëme financiare mbi **100,000.00 €** (Njëqind mijë euro), përkundër faktit se i njëjti është detyruar të marrë një kredi në shumën prej **150,000.00 €** (Njëqind e pesëdhjetë mijë euro), megjithatë as ajo nuk i ka mjaftuar që t’i kompensojë të pandehurit për paratë e marra me anë të kamatës së kundërligjshme – fajdes, me ç’rast pas ekzekutimit të urdhër kontrollit në shtëpinë edhe objektet përcjellëse të të pandehurit E.K, policia ka arritur të sekuestrojë të holla në shumën prej **8,935.00 €** (Tetëmjë e nëntëqind e tridhjetë e pesë euro); **580.00 CH** (Pesëqind e tetëdhjetë franga zvicerane); **1,000.00 \$** (Njëmijë dollarë amerikanë) dhe **17,700.00 Lekë** shqiptare si dhe një automjet të markës “AUDI”, për të cilat ekziston dyshimi i bazuar se janë dobi pasurore e fituar me kryerjen e veprës penale.

I pandehuri i arrestuar, gjendet nën masën e ndalimit 48 orësh, dhe brenda afatit ligjor, për të njëjtin, prokuroria do të parashtrij kërkesë për caktim të masës së paraburgimit. Prokuroria Themelore në Prizren, vazhdon të mbetet e përkushtuar në luftën ndaj kriminalitetit, forcimin e sundimit të ligjit dhe vënien para drejtësisë të të gjithë atyre që bien ndesh me ligjin.



## Kryeprokurori i Prizrenit Priti në Takim Avokatin e Popullit

Prizren, 18 Mars 2025

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, Petrit Kryeziu, priti sot në një takim pune Avokatin e Popullit, Naim Qelaj, me bashkëpunëtor, ku u bisedua për sfidat, me të cilat ballafaqohen të dyja institucionet gjatë përmbushjes së kompetencave dhe mandateve kushtetuese e ligjore që kanë.

Me theks të veçantë në këtë takim u diskutua për zbatimin e rekomandimeve të institucionit të Avokatisë së Popullit nga ana e Prokurorisë së Prizrenit, lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut të garantuara me kushtetutën e vendit, si dhe me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare, të zbatuara në Republikën e Kosovës.

Të dyja palët u pajtuan që të angazhohen në intensifikimin e bashkëpunimit në mes këtyre dy institucioneve, në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut, zbatimit të ligjshmërisë dhe fuqizimit të sundimit të ligjit në vendin tonë.



## Prokuroria e Prizrenit Kërkon Paraburgim për të Pandehurin e Arrestuar për Fajde dhe Detyrim

**Prizren, 21 Mars 2025**

Prokuroria Themelore në Prizren, njofton opinionin publik se ka arrestuar në flagrancë personin me inicialet Z.V., për shkak të dyshimit të bazuar se i njëjti ka kryer veprat penale “Fajdeja” nga neni 331 par.1, dhe “Detyrimi” nga neni 328 par.1, sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

I pandehuri Z.V., që nga data 01.03.2025 deri me datë 19.03.2025 e në vazhdimësi, në Prizren, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të pasurisë për vete, kontraktonte një shumë dukshëm jo proporcionale të pasurisë në këmbim të shërbimit (dhënies së borxhit), duke shfrytëzuar gjendjen e rëndë financiare të të dëmtuarit E.H., në atë mënyrë që i dëmtuari me datë 01.03.2025 kishte huazuar nga i pandehuri një shumë të caktuar parash, me afat të kthimit prej tre-katër ditësh.

I dëmtuari duke qenë në gjendje të rëndë financiare, nuk kishte arritur t’ia kthejë shumën e parave, duke kërkuar nga i pandehuri edhe dy ditë shtesë për kthimin e borxhit, ku i dëmtuari pas një jave ia kthen të hollat duke ia dhënë të dëmtuarit shumën e caktuar në emër të kamatës. Pastaj, i pandehuri pas një jave, në vazhdimësi përmes rrjeteve sociale, i bënë presione të vazhdueshme të dëmtuarit, duke e kanosur me qëllim të detyrimit të të dëmtuarit që të veprojë në dëm të pasurisë së tij, duke i kërkuar shumën e tjera të parave në emër të kamatës. I pandehuri me datë 20.03.2025 takohet me të dëmtuarin nga i cili pranon shumën e caktuar në emër të kamatës, dhe arrestohet në flagrancë nga policia.

Me këto veprime, i pandehuri i lartëcekur, ka kryer veprat penale: “Fajdeja” dhe “Detyrimi” sipas KPRK-së. Për të pandehurin e arrestuar, prokuroria ka parashtruar kërkesë për caktim të masës së paraburgimit.

Prokuroria Themelore në Prizren, vazhdon të mbetet e përkushtuar në luftën ndaj kriminalitetit, forcimin e sundimit të ligjit dhe vënien para drejtësisë të të gjithë atyre që bien ndesh me ligjin.



## PROKURORIA THEMELORE NË PRIZREN



Prokuroria e Prizrenit Kërkon  
Paraburgim për të Pandehurin  
e Arrestuar për Fajde dhe  
Detyrim

## Aktakuzë Kundër Dy Personave për Sulm dhe Kanosje

**Prizren, 25 Mars 2025**

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurve F.D.(1972), dhe F.D.(1992), për shkak të dyshimit të bazuar mirë se secili veç e veç kanë kryer veprat penale “Sulmi” nga neni 184 par.1, dhe “Kanosja” nga neni 181 par.2 lidhur me par.1, sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Sipas aktakuzës, i pandehuri i parë F.D.(1972), me datë 09.02.2025, rreth orës 17:20<sup>min</sup>, në Prizren, përdor forcën fizike ndaj të dëmtuarve A.M., dhe M.J., për shkak të një mosmarrëveshjeje të mëhershme në mes tij dhe të dëmtuarit M.J., lidhur me publikimin e disa informatave dhe lajmeve në rrjetet sociale, për partinë “KDTP” dhe për kryetarin e partisë-të pandehurin F.D.(1972), derisa të dëmtuarit ishin duke qëndruar në parkun e lagjes me disa anëtarë tjerë të partisë së tyre “YTHP”, për një moment i pandehuri hyn në park dhe me vrull i afrohet të dëmtuarës, dhe i drejtohet me fjalë kanosëse, dhe më pas me dy duart e kap të dëmtuarën nga pjesa e supeve dhe e shtynë, ku më pas aty ndërhyjnë të pranishmit dhe e largojnë të njëjtën nga parku, më pas i pandehuri i drejtohet të dëmtuarit M.J., me fjalë kanosëse dhe menjëherë e sulmon, duke e goditur me trupin e tij, trupin e të dëmtuarit dhe me kokën e tij e shtyen kokën e të dëmtuarit, me ç`rast tek i dëmtuari shkakton dhimbje fizike. Me këto veprime, i njëjti kryen veprën penale “Sulmi” sipas KPRK-së.

Po ashtu, i pandehuri i parë F.D. (1972), seriozisht i kanosë me fjalë, të dëmtuarit A.M., dhe M.J., se do t`i privojë nga jeta, me ç`rast të dëmtuarve u shkakton frikë, ankth dhe pasiguri personale. Me këto veprime i njëjti, kryen veprën penale “Kanosja” sipas KPRK-së.

Ndërsa, i pandehuri i dytë F.D. (1992), me datë 09.02.2025, rreth orës 17:20<sup>min</sup>, në Prizren, përdor forcën fizike ndaj të dëmtuarit M.J., në atë mënyrë që për shkak të rrethanave të cekura si më lart, të njëjtin e sulmon duke e shtyer me duar nga gjoksi i të dëmtuarit, me

ç`rast tek i dëmtuari shkakton dhimbje fizike. Me këto veprime, i njëjti kryen veprën penale “Sulmi” sipas KPRK-së.

Gjithashtu, pandehuri i dytë F.D. (1992), seriozisht e kanosë me fjalë të dëmtuarin M.J., se do t’i shkaktojë ndonjë të keqe, me qëllim të frikësimit dhe shkaktimit të ankthit, në atë mënyrë që, pasi e sulmon të dëmtuarin, i drejtohet me fjalë kanosëse, me ç`rast tek i dëmtuari shkakton frikë, ankth dhe pasiguri për jetën e tij. Me këto veprime, i njëjti ka kryer veprën penale “Kanosja” sipas KPRK-së.

Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre, të pandehurit e lartëcekur për veprat penale për të cilat akuzohen të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit.



**Prokuroria e Prizrenit Kërkon Paraburgim për dy të Pandehurit e Arrestuar për Fajde, Detyrim dhe Armëmbajtje pa Leje**

**Prizren, 27 Mars 2025** – Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Krimeve të Rënda, njofton opinionin publik se në bashkëpunim me Njësinë Rajonale të Policisë në Prizren dhe Drejtorinë për Krim të Organizuar, duke zbatuar masat e veçanta të hetimit dhe vëzhgimit, kanë realizuar kontroll në regjionin e Prizrenit, me ç’rast kanë arrestuar dy të dyshuarit E.K., dhe B.K., për shkak të dyshimit të bazuar se të njëjtit në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale “Fajdeja” nga neni 331 par.3, lidhur me nenin 31 sipas KPRK. Po ashtu, i pandehuri B.K., veprën penale “Detyrimi” nga neni 328 par 2-1, dhe E.K., veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1, sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Të pandehurit E.K., dhe B.K., që nga muaji shkurt i vitit 2021, e në vazhdimësi, në Prizren, kontraktojnë shuma dukshëm jopropocionale në këmbim të shërbimit për viktimën E.G., duke e shfrytëzuar, gjendjen e rëndë financiare, papërvojën ose paaftësinë për të kuptuar pasojën, në atë mënyrë që i japin viktimës para (të holla) në formë të borxhit me kamata të paligjshme (fajde), të cilat kamata vazhdojnë t’ia rrisin pandërprerë sa herë që viktimja has në vonesa të kthimit të parave.

Në këtë rast, viktimja E.G., nga muaji shkurt i vitit 2021 e deri në muajin shkurt të vitit 2025, ka paguar kamata mujore në shumë prej 1650 € (një mijë gjashtëqind e pesëdhjetë euro), e cila kamatë ka arritur vlerën mbi 25.000 € (njëzet e pesë mijë euro).

Po ashtu, i pandehuri E.K., me datë 18.03.2025 i dërgon sms viktimës E.G., duke i thënë se i ke borxh 13,650 € (trembëdhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë euro) ose e bartë banesën tek noteri në emrin e tij. Të njëjtit, me datë 26.03.2025 takohen në njërin prej lokaleve në Prizren, dhe pas bisedës rreth borxheve dhe kamatës, të pandehurit nga viktimja marrin edhe 10,000 € (dhjetë mijë euro) me ç’rast intervenon policia dhe të njëjtit arrestohen.

Gjithashtu, i pandehuri B.K., me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vehte përdorë forcën duke detyruar të dëmtuarin E.G., të kryej veprime në dëm të pasurisë së tij, në atë mënyrë që pasi nuk ka qenë në gjendje për ta realizuar kthimin e borxhit që ka rezultuar nga dhënia e fajdesë, në mënyrë të dhunshme ia merr automatin Golf VII, ia heq nga dora orën të dëmtuarit në vlerën prej 1300 € (një mijë e treqindë euro) si dhe e kërcënon se nëse nuk paguan borxhin dhe kamatat e lartcekura do të shkojnë tek noteri për ta bartur banesën e të dëmtuarit në posedim të tij. Me këto veprime, kryen veprën penale “Detyrimi” sipas KPRK-së

Gjithashtu, i pandehuri E.K., në kundërshtim me ligjin për armët, posedon një (1) pistoletë dhe 13 fishekë, një (1) pushkë ajrore dhe një (1) fishekë të armës së gjatë, si dhe 42 fishekë të pistoletës 9x19 mm, dhe një (1) karikator të zbrazët. Me këto veprime kryen

veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” sipas KPRK-së.

Me rastin e ekzekutimit të urdhër kontrollit në shtëpinë dhe objektet përcjellëse të të pandehurve E.K., dhe B.K., policia ka arritur të sekuestrojë të holla në shumën totale prej 24.700€ (njëzet e katër mijë e shtatëqind euro), një (1) pistoletë “Pjetro Bereta Gardone” me 13 fishekë, një (1) automjet “Mercedes 2024” C, dyzet e dy (4)2 fishekë të pistoletës 9x19 mm, një (1) karikator i zbrazët, një (1) pushkë ajrore dhe një (1) fishekë të armës.

Për të pandehurit e arrestuar, prokuroria ka parashtruar kërkesë për caktim të masës së paraburgimit.

Prokuroria Themelore në Prizren, vazhdon të mbetet e përkushtuar në luftën ndaj kriminalitetit, forcimin e sundimit të ligjit dhe vënien para drejtësisë të të gjithë atyre që bien ndesh me ligjin.

